



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS

Nr. 6380 Prot

Vau Dejes, më 17.09.2026

Lënda: Kërkese për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

Z.Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkelidhur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për “**NDRYSHIMIN E VKB NR 74 DATË 23.12.2025 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2026 – 2028, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”**, për Bashkine Vau Dejës"

Duke ju uruar pune të mbarë!

KRYETARI

Kristian SHKRELI



Date _____

Nr. i faqeve A4 te projekt vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 te relacionit shoqerues: _____

Nr. i fleteve te dokumenteve qe shoqerojne projekt-vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13, datë 27.09.2026

“PËR

**NDRYSHIMIN E VKB NR 74 DATË 23.12.2025 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË
VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2026
– 2028, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika” 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Ligjin 87/2025 “Per buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026,VKB-ne nr 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Perfundimtar 2026 – 2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës ”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026 dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2026 - 2028, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 01 (transfertë e pakushtezuar e përgjithshme), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2026-2028 , të ndara në korente dhe kapitale, sipas tabelës 1 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
 - b) Fondet buxhetore do kalojnë në programin buxhetor 03280 “Mbrotja nga zjarri dhe mbrotja civile” për financimin e projektit: “Blerje mjeti zjarrefikse”, në vlerën 2,286,000 lekë, Llog.Ekonomike 231- Shpenzime kapitale të trupëzuara ,instistucioni Bashkia Vau Dejës, sipas tabelës Nr.1 së bashkëlidhur këtij projekt vendimi.

- c) Të miratojë ndryshimin e fondeve buxhetore me kapitull 05 (të ardhura), të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2026-2028 , të ndara në korente, sipas tabelës 2 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi
- d) Fondet buxhetore do kalojnë në programin buxhetor **03280 “Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile” për financimin e projektit: “Blerje mjeti zjarrefikse”, në vlerën 1,714,000 lekë, Llog.Ekonomike 231- Shpenzime kapitale të trupëzuara ,instistucioni Bashkia Vau Dejës, sipas tabelës Nr.2 së bashkëlidhur këtij projekt vendimi.**
- e) Të miratojë rishpërndarjen e cash-it në vlerën prej **1,500,000 lekësh** , me kapitull 01 , sipas tabelës nr 3, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.
- f) Të miratojë rishpërndarjen e cash-it në vlerën prej **1,714,000 lekësh** , me kapitull 05 , sipas tabelës nr 4, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kristian SHKRELI



Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

[Handwritten signature]

Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Integritetit dhe Aseteve

[Handwritten signature]

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Emergencave Civile

[Handwritten signature]

Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 1: "Shtesë projekti dhe Rishperndarje e buxhetit ndermjet programeve te Kap 01".

PAKËSOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	6020000	3333	9999999	1,500,000.00	
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	08130	2310000	3333	1570873	786,000.00	Rikonstrukcion fusha e futbollit Bushat+Mbikqyrje+Kolaudim
SHUMA TOTALE Kap 01										2,286,000.00

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucionit	Kap	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157/00		2157001	Bashkia Vau-Dejes	01	03280	2310000	3333		2,286,000.00	Blerje mjete zjarrefikës
SHUMA TOTALE Kap 01										2,286,000.00

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues

Kryetar

Kristian Shkreli



Institucioni: Bashkia Vau Dejës

Tabela Nr 2: "Shtesë projekti dhe Rishperdarje e buxhetit ndërmjet programeve të Kap 05".

PAKËSOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	03280	6040000	3333	9999999	1,714,000.00	
SHUMA TOTALE Kap 05										1,714,000.00

SHTOHET

Në Lekë

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Emër Institucioni	Kap	Programi	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Kodi i produktit	Debiti 2026	Emërtimi i Projektit
157	00	2157001	Bashkia Vau-Dejes	05	03280	2310000	3333		1,714,000.00	Blerje mjetei zjarrefikës
SHUMA TOTALE Kap 05										1,714,000.00

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi

Nëpunësi Autorizues

Kryetar

Kristian Shkreli



INSTITUCIONI: BASHKIA VAU DEJËS
Tabela Nr 3: "Rishperndarje CASH-I me Kap 01"
PAKËSOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157/00		2157001 01		6029999	3333	1,500,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 01						1,500,000.00	

SHTOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157/00		2157001 01		2319999	3333	1,500,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 01						1,500,000.00	

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues
Kryetar

Kristian Shkrel



INSTITUCIONI: BASHKIA VAU DEJËS

Tabela Nr 4: "Rishpermdarje CASH-I me Kap 05"

PAKËSOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157/00		2157001/05		6029999	3333	1,714,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 05							1,714,000.00

SHTOHET

Entit.i Qev.	Min.e Linjes	Kod Instit.	Kap.	Llog. Ekon.	Kodi i Degës së Thesarit	Debiti	Emër Institucioni
157/00		2157001/05		2319999	3333	1,714,000.00	Bashkia Vau-Dejes
TOTALI KAP 05							1,714,000.00

Nëpunësi Zbatues

Elsa Tanushi



Nëpunësi Autorizues

Kryetar

Kristian Shkrelli



RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

NDRYSHIMIN E VKB NR 74 DATË 23.12.2025 “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PERFUNDIMTAR 2026 – 2028, NUMRIN E PUNONJËSVE TË BASHKISË VAU DEJËS”.

QËLLIMI I PROJEKT VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vendimit të Këshillit nr 74 datë 23.12.2025 “Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”, dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me 884/1 prot datë 07.01.2026, duke plotësuar nevojat e bashkise Vau Dejës.

Duke u nisur nga shkresa Nr. 6357 Prot datë 16.09.2026 e Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi drejtuar Sektorit të Buxhetit dhe Financës me lëndë “Kërkesë për planifikim dhe prokurimin e automjeteve zjarrfikëse për Sektorin e MZSh-së” jemi angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e nevojshme për shtimin e kapaciteteve të mjeteve zjarrfikës në dispozicion të Bashkisë sic na është cituar në shkresë, për të paktën një automjet zjarrfikës duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore. Po ashtu në buxhetin e vitit 2026 do të bëhet shtesë e zërit me emërtimin **“Blerje mjeti zjarrfikës ”**.

Më këtë projekt vendim propozohen të bëhen ndryshime të buxhetit sipas tabelës 1, për vitin 2026. Në zbritje do të jetë zëri i investimit **“Rikonstruksion fusha e futbollit Bushat+Mbikqyrje+Kolaudim” në vlerën prej 786,000 lekësh** për arsye se ky investim nuk do të realizohet këtë vit, gjithashtu do kemi pakësim në vlerën prej **1,500,000 lekësh nga llogaria ekonomike 602 (shpenzime operative)** pasi nga parashikimet e bëra në buxhetin fillestar dhe me realizimin e pjesës më të madhe të këtyre shpenzimeve deri tani, kemi tepriçë fondesh që praktikisht i bie të jenë fonde të trashëguara nga vitet e kaluara, kryesisht mbetje të akumuluar në vite, dhe që janë realizuar pjesesisht si shpenzim, për këtë arsye kemi pakësuar këto fonde.

Në tabelën nr 2 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi kemi gjithashtu paksim në vlerën prej **1,714,000 lekësh nga llogaria 604 (transferime)**, fonde që parashikohen minimalisht prej 4 % të totalit të buxhetit vjetor sipas ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 65 *Buxheti i Bashkive*, pika 1. Këto fonde janë në tepriçë pasi janë të trashëguara dhe të papërdorura nga viti në vit.

Në tabelat nr 3 & 4 kemi rishpërndarjen e cash-it ndërmjet programeve në kapitujt përkatës sipas rishpërndarjeve të buxhetit.

Kemi prekur zëra buxheti që kanë mjaftueshmëri fondesh, dhe propozojmë realizimin e rishpërndarjes në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së veteqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit 2026”; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 74 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026-2028, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës” miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 884/1 prot datë 07.01.2026.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me:

- Ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

- Ligji nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"
- Ligji 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"
- Udhëzimit Plotesues nr 02 date 14.01.2026 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2026"
- Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74 datë 23.12.2025 "Miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2026 – 2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 884/1 prot datë 07.01.2026

Bashkëngjitur :

- Shkresa nr.6357 prot datë 16.09.2026 me lëndë: Kërkesë për planifikim dhe prokurimin e automjeteve zjarrfikës për sektorin e MZSH-së".

KRYETAR
Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Nr. 635



Vau Dejës, më 6 09/2026

Drejtuar:

Sektorit të Financës

Sektorit të Prokurimeve

Për dijeni:

KRYETARIT TË BASHKISË VAU DEJËS

Lënda: Kërkesë për planifikimin dhe prokurimin e automjeteve zjarrfikëse për Sektorin e MZSH-së

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe institucionale të Sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe me qëllim garantimin e një shërbimi sa më të shpejtë dhe efektiv ndaj situatave emergjente, paraqesim nevojën për shtimin e kapaciteteve të mjeteve zjarrfikëse në dispozicion të Bashkisë Vau Dejës.

Territori që mbulohet nga Sektori i MZSH-së së Bashkisë Vau Dejës përfshin zona urbane dhe rurale, sipërfaqe pyjore dhe bujqësore, banesa, biznese dhe objekte të ndryshme, ku gjatë vitit evidentohen raste të zjarreve dhe emergjencave të ndryshme që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

Në këto kushte, disponueshmëria e një numri të mjaftueshëm automjeteve zjarrfikëse, të pajisura dhe funksionale, është një element i rëndësishëm për garantimin e reagimit në kohë, veçanërisht në rastet kur paraqiten më shumë se një situatë emergjente në të njëjtën kohë ose kur ndërhyrja kërkon angazhimin e disa mjeteve.



Gjithashtu, përdorimi i vazhdueshëm i mjeteve ekzistuese, vjetërsia dhe gjendja e tyre teknike, si dhe kostot e mirëmbajtjes, ndikojnë drejtpërdrejt në gatishmërinë operationale të shërbimit. Për këtë arsye, vlerësojmë se rinovimi dhe shtimi i flotës zjarrfikëse është një nevojë e rëndësishme për rritjen e kapaciteteve të MZSH-së.

Për sa më sipër, kërkojmë:

1. Sektori i Financës të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë mundësinë e planifikimit të fondit të nevojshëm për blerjen e një ose më shumë automjeteve zjarrfikëse.
2. Sektori i Prokurimeve të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së këtij investimi në planin e prokurimeve dhe, pas përcaktimit të fondit, të ndjekë procedurat përkatëse për prokurimin e mjeteve zjarrfikëse.
3. Në bashkëpunim me Sektorin e MZSH-së, të përcaktohen specifikimet teknike dhe kapacitetet e nevojshme të mjeteve, në përputhje me nevojat reale të territorit që mbulojmë.
4. Të vlerësohet mundësia që kjo nevojë të përfshihet në planifikimin buxhetor të Bashkisë Vau Dejës, duke i dhënë prioritet forcimit të kapaciteteve të shërbimit të MZSH-së.

Theksojmë se sigurimi i mjeteve të përshtatshme zjarrfikëse do të ndikojë në rritjen e gatishmërisë operationale, shkurtimin e kohës së reagimit dhe përmirësimin e kapacitetit për përballimin e emergjencave, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit.

Për çdo informacion shtesë dhe për përcaktimin e specifikimeve teknike, Sektori i MZSH-së është në dispozicion.

SHEFI I SEKTORIT TË MZSH-së

Glen Rrotomi

